



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur
më 10.05.2017, e cila filloi në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Agim Gashi, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Mirlinda Sopi, shefe e GP të AKR-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Munguan: Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së dhe Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Besart Vllahinja, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, përfaqësues të INPO – së, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Dardan Sejdiu**, nënkryetar i Komunës, në emër të kryetarit, propozoi të shtohet në rend dite pika "Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten". Për këtë materialin shtesë ua kemi dorëzuar sot, andaj propozojmë që të futet si pikë e 13-të e rendit të ditës.

Agim Gashi tha se në materialin e dërguar për Kuvend është shtuar një pikë e rendit të ditës dhe konsideroj se materiali për Kuvend është në kundërshtim me procedurat, sepse Kuvendi thirret 7 ditë pune pas mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Për pikat 6 dhe 12 nuk kemi sqarime, sepse pika 6 bie ndesh me nenin 7.2 të Ligjit për dhënien dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, sepse ky propozim nuk e ka arsyetimin e dhënë dhe nuk e dimë se për çka do të votojmë. Po ashtu, pika 12 e versionit për

Kuvend dhe dhënia e pronës në shfrytëzim për Ambasadën e Shqipërisë, konsideroj se prapë nuk është përfillur procedura shtetërore për ndarjen e një parcele për nevojat e një ambasade. Do të ishte mirë që këto të kompletohen dhe të dërgohet në Kuvend si propozime.

Halim Halimi, kryesues, theksoi se unë rendin e ditës e kamë nënshkruar, por tani po na dalin edhe disa pika shtesë, të cilat nuk kemi mundur as t'i lexojmë dhe të përgatitemi. Sa i përket afatit për dërgimin e materialit, është e vërtetë se mbledhja e Kuvendit duhet të jetë 7 ditë pune pas mbledhjes së KPF-së, mirëpo duke e pasur parasysh se pas datës 15 maj nuk mund të marrim vendime për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme. Është e vërtetë se nuk përmbushet afati prej 7 ditë pune para mbledhjes së Kuvendit, por edhe ekzekutivi është vonuar në përgatitjen e materialeve.

Ardian Olluri dha sqarime lidhur me afatet e thirrjes së mbledhjeve.

Agim Gashi tha se qëllimi është që kur kemi të bëjmë me një vendim për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë, nuk mund të shkojë materiali në Kuvend para se të shkojë në KPF, sepse është obligative të kalojë në KPF. Edhe çështja e mos marrjes së materialeve me kohë, sidomos kur janë pikat e rendit të ditës me peshë të madhe, siç është dhënia e pronës në shfrytëzim, kërkohet afat 7 ditë që të trajtohen temat brenda GP-ve, ashtu siç e parasheh edhe ligji.

Qëndron Kastrati tha se kemi deklaruar në të kaluarën që pikat që nuk sillen me kohë nuk i trajtojmë, por në këtë rast kërkoj nga anëtarët e Komitetit që të trajtohen për arsye të afatit ligjor 6-mujor para përfundimit të mandatit dhe duke pasur parasysh se është vetëm vendimi i parë, d.m.th. fillimi i një projekti, do ta trajtojmë prapë edhe në të ardhmen. Do të ishte mirë të vazhdohej me përkrahjen e projekteve të tilla.

Ai paraqiti edhe një kërkesë për nënkryetarin ose Zyrën ligjore, që ka të bëjë me pikën "Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten"", se si e keni menduar shmangien e konkurrencës në këtë aspekt, sepse siç e kemi kuptuar dhe diskutuar, nuk ka vazhdim të afatit për dhënie të pronës në shfrytëzim, por ka konkurrencës ose shmangie të konkurrencës. Në bazë të materialit, nuk e pash se ku është e bazuar shmangia e konkurrencës.

Ardian Olluri theksoi se kjo është kërkesë e Ministrisë.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, tha se kjo është dhënia në shfrytëzim afatgjatë dhe vjen dy here në Kuvend. Në këtë rast është miratimi paraprak, vendimi paraprak, vendimi përfundimtar i lihet legjislaturës së ardhshme, ajo çka po kërkojmë është të fillojmë punën për caktimin e kriterëve në ecjen përpara me projektin. Sa i përket materialeve që janë ardhur me vonesë, jam dakord me kryesuesin, mirëpo në anën tjetër mendoj ky komitet i diskuton, i këshillon dhe në fund vendimin përfundimtar e japin në Kuvendin e Komunës, andaj të jemi të pajtimit për materialet që janë si shtesë e rendit të ditës.

Lirak Çelaj bëri vërejtje në rolin e Komitetit, në mënyrën se si thirret mbledhja, në mënyrën se kush e thërret mbledhjen e Komitetit, kush e përcakton rendin e ditës, pra është zhvlerësuar kompletë roli që ka.

Sa i përket pikës për deponinë në Drenoc, është diçka që duhet diskutuar në parim.

Halim Halimi, kryesues, kërkoi nga Zyra ligjore që të jetë më në nivel, në mënyrë që materiali të sillet me kohë.

Qëndron Kastrati tha se të gjitha materialet që kanë ardhur me vonesë janë propozime për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë.

Mirlinda Sopi theksoi se nëse materialet janë sjellë me vonesë dhe janë në kundërshtim me ligjin, jemi vonë për t'i kthyer mbrapa, nuk mund ta shkelim ligjin, nuk mundemi për diçka ta shkelim ligjin e për diçka jo.

Halim Halimi, kryesues, kërkoi të vazhdohet me rendin e ditës dhe propozimin për shtimin e pikës së re.

Halim Halimi, kryesues, tha se ky është rendi i ditës me propozimin e z. Sejdiu, që të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoeten"", si pikë e 13-të e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbalit të mbledhjes së parë dhe të dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Diskutim lidhur me raportin tremujor financiar, janar - mars 2017;
3. Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2016 në vitin 2017;
4. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë;
6. Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objekteve shumëbanesore, parcelat: 1180-1, 1185-1, 1183-2, 1184-1, 1178-0, 1177-0, 1179-0 dhe 1176-0K Bernicë e Epërme;
7. Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e depos, ku do të trajtohen mbetjet e materialeve ndërtimore, parcela 19-0, ZK Drenoc;
8. Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projektplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
9. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1";
10. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagja "Mati 1" 2017 - 2025;
11. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura";
12. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë;

13. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve “Vier Pfoten”;

14. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbalit të mbledhjes së parë dhe të dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash dhe 2 (dy) abstenime (Hatixhe Hoxha dhe Qëndron Kastrati) u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe të dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Diskutim lidhur me raportin tremujor financiar, janar – mars 2017.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, dha sqarime lidhur me raportin tremujor financiar, janar – mars 2017, duke thënë se në raportin tremujor janë përpjekur t'i paraqesin pasqyrat financiare reale të gjendjes në Komunën e Prishtinës. Realizimi i përgjithshëm i asaj që është planifikuar sa i përket të hyrave vetjake, është 24.80 % për tremujorin e parë dhe jam i kënaqur posaçërisht për të hyrat që po realizohen nga taksat prej lejeve të ndërtimit, ku tani në tremujorin e parë e kemi kaluar 35%. Po ashtu, numri i shërbimeve që po jepet në QMF –të në Prishtinë tash është në shpërputhje me kapacitetet financiare buxhetore që i ka Komuna e Prishtinës, kemi një fluks të madh të qytetarëve që vijnë nga qytetet tjera dhe marrin shërbime në Komunën e Prishtinës.

Puna që po bëhet në realizimin e të hyrave dhe në tatimin në pronë, është në rrjedhë të mirë. Më shumë kemi realizuar gjatë këtij tremujori sesa në tremujorin e vitit 2016, e njëjta vlen edhe për leje ndërtimi.

Agim Gashi theksoi se realizimi i të hyrave në këtë tremujor është mjaft i mirë. Nëse ruhet kjo dinamikë, deri në fund të hyrat do të realizohen 100%. Ai cekur se janë disa gabime teknike, e që drejtori i Financave do të duhej sqaruar.

Ismail Kokaj dha sqarime, duke cekur se nuk ka gabime në këto të dhëna.

Agim Gashi sugjeroi që të shikohet faqja e 8-të, sepse ka më shumë shpenzim sesa planifikim, se dallimi është shumë i madh në tremujor.

Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj dhe Mirlinda Sopi u deklaruan se në Kuvend do të debatojnë lidhur me raportin tremujor financiar, janar – mars 2017.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah raporti tremujor financiar, janar – mars 2017, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2016 në vitin 2017.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, theksoi se arsyetimi është i qartë dhe i përmbledhur.

Agim Gashi shprehu mendimin që të mbetet të diskutohet në Kuvend, sepse te bartjet kapitale ne do ta sjellim një kërkesë. Njëherësh u interesua pse në vitin e kaluar nuk janë

paguar obligimet ndaj projektit të Ujësjiellësit dhe projektit të kogjenerimit të sistemit të ngrohjes.

Ismail Kokaj dha sqarime se këto obligime të vitit të kaluar janë paguar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2016 në vitin 2017 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribuium dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Qëndron Kastrati shprehu shqetësimin, të cilin e kanë shprehur edhe në të kaluarën për dhënien e pronës në shfrytëzim pa kompensim një korporate private.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribuium dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë.

Agim Gashi tha të mbetet për Kuvend të diskutojmë më gjerësisht, të na jepen sqarime të hollësishme, në parim jemi për.

Lirak Çelaj përkrahu diskutimin në Kuvend.

Mirlinda Sopi tha se do të duhej që Drejtoria e Pronës të na japë sqarime, por le të mbetet për Kuvend të na japin sqarimet e nevojshme.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, e udhëzoi drejtorin e Drejtorisë së Pronës ose të Urbanizmit, që para Kuvendit dhe këshilltarëve komunalë të bëjë prezantim të secilit këmbim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objekteve shumëbanesore, parcelat: 1180-1, 1185-1, 1183-2, 1184-1, 1178-0, 1177-0, 1179-0 dhe 1176-0K Bërnice e Epërme.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, dha sqarime për këtë. Ai tha se në pikën 1 të propozimvendimit thuhet "... për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për ndërtimin e objekteve shumëkatëshe për punëtorët e sektorit publik të komunës së Prishtinës, me procedurë konkurrimi", pra logjika është ndërtimi i objekteve me kosto të përballueshme për punëtorët e sektorit publik të komunës së Prishtinës.

Agim Gashi theksoi se materiali nuk është i kompletuar. Gjithashtu, dikush duhet të na referojë se si e kanë menduar ta realizojnë këtë projekt, që të jenë gjërat e qarta, sepse në parim Komuna nuk ka të drejt të shesë prona.

Lirak Çelaj shprehu mendimin se për çështje kaq të rëndësishme sot këtu do të duhej ta kishim një prezantim të hollësishëm, e jo prej kryetarit në asamble, sepse duhet ta kemi një qëndrim para se të dërgohet për seancën e Kuvendit dhe një përshkrim detal prej 2-3 faqesh për projektin.

Halim Halimi, kryesues, theksoi se tash e mora materialin, e që materiali do të duhej të na vinte me kohë, një javë përpara. Unë tani nuk mund të përcaktohem as për, as kundër. Kjo pikë i plotëson kushtet për t'u hequr nga rendi i ditës.

Qëndron Kastrati u shpreh, ashtu siç e kuptoj unë, vendimi paraprak, vendimi i parë ka të bëjë se a pajtohemi me këtë çështje, banim për punëtorët e sektorit publik.

Ardian Olluri dha sqarime, duke cekur se ky është propozimi, është për vendimin paraprak për me dhënien shfrytëzim afatgjatë. Pasi të miratohet ky vendim komisioni, i cili është i përbërë nga anëtarët e Kuvendit dhe të ekzekutivit, i cakton kriteret e ankandit, i përzgjedh përfituesit, e pastaj vendimi përfundimtar vjen prapë në Kuvend për miratim final.

Agim Gashi theksoi se këtu kërkohet arsyetim i plotë.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, u shpreh se në Kuvend do të jetë kryetari i Komunës, i cili e ka projektin në detale, së bashku me drejtorin e Pronës që e ka zhvilluar, përderisa synimi është i qartë, politika është e qartë, metoda me të cilën mendojmë ta bëjmë këtë politikë është e qartë. Shpresoj se për mbledhje të Kuvendit do ta bëjë kryetari këtë prezantim të politikës me shkrim dhe prezantim të kësaj.

Lirak Çelaj shprehu mendimin se nuk është koha me dhënë banesa falas, andaj në parim nuk pajtohem. Kemi nevojë për sqarime se si ka me funksionuar, a blihet apo jepet vetëm në shfrytëzim.

Mirlinda Sopi tha nëse veç është jashtëligjore, nëse Zyra ligjore i merr kompetencat dhe thotë se nuk ka asgjë të kundërligjshme sa i përket materialeve që po vijnë me vonesë, në rregull, veç ligji mos të shkelet, ndërsa sa i përket kësaj se a jemi për apo kundër, duhet konsultuar me grupin e në Kuvend japim qëndrimin se ka ardhur materiali me vonesë.

Qëndron Kastrati tha se Komiteti për Politikë dhe Financa mund t'i rekomandojë Kuvendit një qëndrim me aprovuar apo mos me e aprovuar, sepse nuk i takon as nuk është organ që merret me organizimin e rendit të ditës të Kuvendit të Komunës.

Halim Halimi, kryesues, tha se ky material na ka ardhur sot, e është dashur të sillej 7 ditë përpara. Si Komitet mund të marrim rekomandim dhe qëndrim, por jo vendime, vendimin e merr Kuvendi. Unë po e qes në votim si komitet, si qëndrim me u hequr nga rendi i ditës apo jo, se për Kuvend ne do ta dërgojmë, e Kuvendi vendos a e përfshinë në rend dite.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që të përcillet në Kuvend Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objekteve shumëbanesore, parcelat: 1180-1, 1185-1, 1183-2, 1184-1, 1178-0, 1177-0, 1179-0 dhe 1176-0K Bërnice e Epërme, me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa se ka ardhur materiali me vonesë.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e depos, ku do të trajtohen mbetjet e materialeve ndërtimore, parcela 19-0, ZK Drenoc.

Lirak Çelaj u shpreh kundër këtij propozimvendimi. Pse në Barilevë, kur ne kemi marrë vendim të jetë në Hajvali, për këtë dua sqarime, sepse mendoj që nuk është zgjidhja më e mirë. Po ashtu, u interesua të dijë se a duhet të shfuqizohet më parë vendimi paraprak.

Ardian Olluri dha sqarime, duke cekur se vendimi i parë ka qenë për caktimin e lokacionit, ndërsa ky është vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim.

Në mbledhjen e ardhshme do ta sjellim një vendim të veçantë për shfuqizimin e vendimit. Agim Gashi tha se pasi që kemi të bëjmë me riciklimin e mbeturinave, ky proces i nënshtrohet ligjit për menaxhimin e mbeturinave dhe ligjeve të tjera të ambientit, andaj kur të jepen propozimet për ndarjen e lokacioneve për deponimin ose trajtimin e mbeturinave, duhet me pasur pëlqimin nga Ministrisë e Ambientit Hapësinor. Këtij dokumenti i mungon ai pëlqim i Ministrisë, ky dokument duhet të plotësohet me kriteret.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, kërkoi nga Zyra ligjore të konsultohet me Ministrinë se a duhet kjo që e potencoj z. Gashi, në mënyrë që asamblistët ta kenë këtë informatë në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah të dërgohet në Kuvend Propozimvendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e depos për trajtimin e materialeve ndërtimore, parcela 19-0, ZK Drenoc, me kusht që Zyra ligjore të konsultohet me Ministrinë për kriteret.

Pika e tetë

Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projektplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projektplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika dhjetë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagja "Mati 1" 2017 - 2025.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagja "Mati 1" 2017 - 2025 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura".

Agim Gashi tha se nuk e di çka kanë dashur me bërë me këtë, nuk kam informacione.

Mirlinda Sopi tha se edhe ne nuk po e kuptojmë.

Ardian Olluri bëri të ditur se është fjala për ngritjen e fidanishtes dhe serrave, nuk e kemi cekur, por për Kuvend do ta përgatisim.

Agim Gashi pyeti se a e ke konsultuar ti, sepse ekziston një vendim i Kuvendit i viti 2012 për ndarjen e lokacionit për kultivimin e fidanëve nga Hortikultura, parcela ekzistuese ku është e vendosur Hortikultura dhe Njësia e zjarrfikësve, ajo hapësira e lirë ka qenë e destinuar për kultivimin e fidanëve dhe përpunimin e kompostit.

Halim Halimi, kryesues, kërkoi që të shqyrtohen këto çështje për Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah **Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura"** dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Republikës së Shqipërisë.

Halim Halimi, kryesues, tha se edhe kjo pikë na ka ardhur sot, sikurse dy pikat tjera. Të përcillet në Kuvend dhe të vendosë Kuvendi.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që të përcillet në Kuvend **Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Republikës së Shqipërisë**, me shqetësimin se materiali ka ardhur me vonësë.

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten".

Agim Gashi u shpreh, si GP i kemi marrë më herët kërkesat nga Fondacioni për mbrojtjen e kafshëve, ku edhe arsyetohet kërkesa e tyre, e që është një donacion që i dedikohet këtij fondacioni.

Fondacionit iu ka caktuar si kusht që Komuna t'ia zgjasë afatin e shfrytëzimit të pronës për 15 vjet, nëse ne vendosim në Kuvend me ia zgjatur afatin e shfrytëzimit të asaj prone Fondacionit, Fondacioni menjëherë e fiton atë donacion pasi që i plotëson kushtet.

Ardian Olluri bëri të ditur se afatin kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për këtë Fondacion e kemi caktuar afatgjatë, për 99 vjet.

Halim Halimi, kryesues, u shpreh se edhe kjo pikë ka ardhur sot, le të përcillet për Kuvend, pastaj le të vendos Kuvendi me shqetësimin se materiali s'ka ardhur me kohë.

Mirlinda Sopi u shpreh se nuk jemi në parim kundër këtij Fondacioni, por Zyra ligjore të na japë sqarime.

Qëndron Kastrati kishte kërkesë lidhur me shfaqjen e konkurrencës, me e dëshmuar me dokument.

Ardian Olluri tha se nuk e di pse nuk është bashkangjitur, sepse ekziston ai dokument.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që të shkojë në Kuvend Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten", me shqetësimin se materiali ka ardhur me vonesë.

Mbledhja përfundoi në orën 16:45.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi/ jur. i dipl.

